

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në Departamentin e Energjistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë diplomë të studimeve universitare në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë (sistemi 5 vjeçar ose Master i Shkencave).
2. Të ketë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare, jo më të ulët se 8 (tetë).
3. Të ketë gradën shkencore “Doktor” në fushën e Inxhinierisë
- 4.
5. Mekanike, profili Energjitikë (brenda ose jashtë vendit).
6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie.
7. Të ketë eksperiencë kërkimore-shkencore në fushën e Energjistikës.
8. Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **23.02.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.